

Dr. Francës

07.01.2022

2P  
07.01.22



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT KUKËS

Nr. 1/63 prot.

L E N D A :

Kukës më, 06.01.2022

Verifikimi i Ligjshmërisë së Akteve.

**KRYETARIT TË BASHKISË**

**KËSHILLIT BASHKIAK**

**KUKËS**

Bazuar në nenin 16, pika 2, shkronja “ b “ e ligjit nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, pasi verifikova kompetencën, juridiksionin dhe bazën ligjore të vendimit të datës 26.11.2021 të Këshillit Bashkiak Kukës

**V E N D O S A :**

**Të Konfirmoj vendimin Nr 73 të datës 26.11.2021, të Këshillit Bashkiak Kukës**

- **Vendim Nr.73;** Këshilli Bashkiak Kukës, në mbledhjen e tij të datës së mësipërme, pasi shqyrtoi projekt-vendimin e paraqitur nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, bazuar në ligjin Nr.139/2015 të miratuar me datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” nenet 8/2, 9/1/1.1/b, 54, ligjin Nr.44/2015, të miratuar me datë 30.04.2015 “Kodi i Proçedurave Administrative të RSH”, ligjin Nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar), ligjin Nr.10 296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” (i ndryshuar) , ligjin Nr.68/2017, te miratuar me datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 33, Ligjin nr.115/2021 datë 25.11.2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, udhëzimin e Ministrise së Financave Nr.8, datë 29.03.2012 “Për proçedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afat-Mesem”, udhëzimin e Ministrise se Financave Nr.2, datë 06.02.2012 “Për proçedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, Udhëzimin Nr. 7, datë 26.02.2021 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2022-2024” Udhëzimin Plotësues Nr.20, datë 09.07.2021 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2022-2024”, Shkresës Nr.18976 prot datë 29.10.2021 “Dërgohet për njoftim transferta e pakushtëzuar e përgjithshme dhe sektoriale, për vitin 2022”, mori vendim:

- 1- Të miratojë kalendarin e aktiviteteve të programit buxhetor afatmesëm (PBA 2023-2025) dhe të buxhetit vjetor 2023, bashkangjitur këtij vendimi.

- 2- Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Buxhetit.
- 3- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Kaq për dijeni.**

